



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. 03 Prot.

Tiranë 24/07/2023

**Lënda:** Mbi dërgimin e listës me emrat avokatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve

DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË  
KRYETARIT  
Z. MAKSIM HAXHIA

*I nderuar z. Kryetar,*

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ju informojmë se më datë 19.07.2023 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.

Avokati i Popullit ka filluar punën për ndjekien dhe zbatimin e procedurave të mëtejshme administrative, për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e caktuara në ligjin e sipërcituar.

Referuar neneve 23 pika 1/c dhe 121 pika 1/c, në përbërje të Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve janë edhe dy avokatë, më i riu dhe më i vjetri në moshë ndër avokatët që plotësojnë në mënyrë kumulative kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (renditur më poshtë), që nuk kandidojnë dhe që janë angazhuar gjatë 5 viteve të fundit në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës ose në Shkollën e Avokatisë.

Për sa më lart, me qëllim krijimin e Komisionit Ad-Hoc në përputhje me nenet 23 e vijues dhe 121 e vijues të ligjit nr. 115/2016, ju drejtohem për të kërkuar nga ana juaj dërgimin e listës me emrat, moshën dhe të dhënat e kontaktit të avokatëve të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë avokatë të licencuar sipas ligjit;
- të kenë shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore dhe ato financiare ndaj Dhomës së Avokatisë;

- të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesionin e juristit, nga të cilat të paktën 10 vitet e fundit të kenë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje;
- të jenë licencuar për të ushtruar profesionin pranë Gjykatës së Lartë ose Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit “Për profesionin e avokatit”;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Në përputhje me pikën 1 të nenit 25 dhe pikën 1 të nenit 123 të ligjit nr. 115/2016 lutemi dërgimin e emrave të mësipërm brenda afatit ligjor 5 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,


**AVOKATI POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**





DHOMA E AVOKATISË  
E SHQIPËRISË  
ALBANIAN CHAMBER OF ADVOCACY



Nr 263 Prot.

Tiranë më, 27/07/2023

**Drejtuar:** Avokatit të Popullit

Tiranë

**Lënda:** Dërgohet lista e avokatëve për Komisionin “Ad hoc”

Bazuar kërkesës së ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenit 23, pika 1/c dhe nenit 121, pika 1/c të tij, si dhe kërkesës tuaj për këtë qëllim, sipas shkresës nr. 03 datë 24/07/2023, bashkalidhur po ju dërgojmë listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat e sipërcituara, për anëtar i Komisionit “Ad Hoc”.

Avokatët e kësaj liste plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 19 të Ligjit dhe njëkohësisht kanë qene pjese e mesimdhënies pranë SHKA dhe Shkolles së Magjistratures për 5 vitet e fundit.

Sqarojme se avokat **Fatmir Braka** është i padisponueshem për periudhën në të cilën është planifikuar aktiviteti i Komisionit Ad-Hoc, për shkak të disa impenjimeve familjare.

Avokate **Aurela Bozo** është shprehur se nuk ka interes për të qene pjese e Komisionit, ndërsa për avokatin **Erajd Dobjani** nuk kemi kontakte, pasi kontaktet e depozituara pranë nesh nuk janë funksionale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Maksim R. HAXHIA**



**AVOKATET KANDIDATE PER KOMISIONIN AD-HOC**

<b>Nr.</b>	<b>Emer</b>	<b>Mbiemer</b>
1	Fatmir	BRAKA
2	Maksim	HAXHIA
3	Sokol	PUTO
4	Arben	VANI
5	Aurela	ANASTASI
6	Genc	CIFLIKU
7	Ardian	LEKA
8	Aurela	BOZO
9	Artan	HAJDARI
10	Genti	SINANI
11	Arben	PRIFTI
12	Ardian	VISHA
13	Irena	RESO
14	Alban	CAUSHI
15	Aranit	ROSHI
16	Envi	HICKA
17	Jordan	DACI
18	Dorina	HOXHA
19	Dritan	JAHAJ
20	Ilir	DODE
21	Erajd	DOBJANI